FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

CUTADIN – S

Krem – 1 %
(Sulfadiazinë argjendike)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Cutadin - S dhe përse përdoret
2. Përpara se të përdorni Cutadin - S
3. Si ta përdorni Cutadin - S
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Cutadin - S
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË CUTADIN-S DHE PËRSE PËRDORET

Cutadin-S përmban lëndën aktive sulfadiazinë argjendike, e cila është një sulfonamid.
Cutadin-S është një bar antimikrobik lokal me spektër të gjerë, që vepron kundër disa baktereve Gram - pozitivë dhe Gram - negativë, përfshirë *Pseudomonas aeruginosa, Escherichia coli* dhe shtamet e ndjeshme të *Proteus spp., Staphylococcus spp., Enterobacter spp., Klebsiella spp.* dhe disa mykeve. Ai ka një veprim baktericid; kripa e argjendit vepron në membranën dhe murin qelizor bakterial.

Cutadin-S përdoret në:
- parandalimin dhe trajtimin e infeksionit në djegie të rënda;
- trajtimin e ulçeracioneve të infektuara të lëkurës (ulçeracionet e këmbës dhe ulçeracionet e shkaktuara nga qëndrimi në pozicionin shtrirë për një kohë të gjatë).

2. PËRPARA SE TË PËRDORNI CUTADIN- S

Mos përdorni Cutadin-S:
- nëse keni mbindjeshmëri ndaj sulfadiazinës argjendike, ndaj çdo sulfonamidi ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të kremit Cutadin-S;
- në fëmijë prematurë dhe në fëmijë të vegjël në muajt e parë të jetës, për shkak të riskut të shfaqjes së kernikterus;
- gjatë tremujorit të fundit të shtatzënisë;
- gjatë ushqimit me gji të fëmijëve prematurë dhe fëmijëve me ikter ose me defiçiencë të glukozë - 6 – fosfatdehidrogjenazës.

Tregoni kujdes të veçantë me Cutadin-S
Kujdes i veçantë duhet treguar në pacientë me:
- defiçiencë të glukozë - 6 - fosfatdehidrogjenazës, për shkak të riskut të hemolizës;
- çrregullim të konsiderueshëm të funksionit të veshkave;
- çrregullim të konsiderueshëm të funksionit të mëlçisë.

Në rastin kur në fillim të trajtimit shfaqet leukopeni, nuk është e nevojshme të ndërpritet përdorimi i kremit Cutadin-S, por këshillohet të monitorohet formula e gjakut.
Përdorimi në zona të mëdha të lëkurës ose për një kohë të gjatë i kremit Cutadin-S, mund të rrisë përqëndrimin sistemik të tij duke shkaktuar kristaluri dhe argiri.

Marrja e barnave të tjera
Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga kremi Cutadin-S.
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë / përdorur ose keni marrë / përdorur kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë.
Nuk rekomandohet përdorimi i njëkohshëm i kremit Cutadin-S dhe preparateve enzimatike të përdorura për largimin e indeve të vdekura nga plagët, sepse përmbajtja e argjendit mund të çaktivizojë këta të fundit.
Për shkak se një sasi e vogël e sulfadiazinës argjendike (e cila është një sulfonamid) përthithet nga lëkura, mund të ndodhin reaksione të ngjashme me ato që vijnë nga përdorimi nga goja i sulfonamidëve.
Tregojini mjekut tuaj nëse po merrni: barna kundër koagulimit të gjakut (antikoagulantë), barna për uljen e sheqerit në gjak (barna antidiabetike orale), barna kundër epilepsisë (difenilhidantoina) ose edhe disa anestezikë lokalë (prokaina, benzokaina dhe tetrakaina).

Shtatzënia dhe ushqyerja me gji
Kremi Cutadin-S mund të përdoret gjatë tremujorit të parë dhe të dytë të shtatzënisë vetëm nëse përfitimi për nënën e tejkalon riskun për fetusin.
Cutadin-S kundërindikohet gjatë tremujorit të tretë të shtatzënisë, për shkak të riskut të shfaqjes së kernikterus tek fëmija i porsalindur.
Gjatë ushqimit me gji duhet vlerësuar me kujdes raporti përfitim risk.
Kremi Cutadin-S kundërindikohet gjatë ushqimit me gji të fëmijëve prematurë dhe fëmijëve me ikter ose me defiçiencë të glukozë - 6 – fosfatdehidrogjenazës.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Kremi Cutadin-S nuk ka ndonjë ndikim mbi aftësinë për të drejtuar automjete dhe për të përdorur makineri.

Informacione të rëndësishme mbi disa nga përbërësit e Cutadin-S
Ky bar përmban:
- propilenglikol, i cili mund të shkaktojë irritim të lëkurës;
- metilhidroksibenzoat, i cili mund të shkaktojë reaksione alergjike (ndoshta të vonuara).

3. SI TA PËRDORNI CUTADIN- S

Kremi Cutadin-S përdoret gjithmonë ekzaktësisht si ju thotë mjeku juaj. Duhet të konsultoheni me mjekun ose me farmacistin tuaj në qoftë se nuk jeni i sigurt.
Kremi Cutadin-S duhet të aplikohet në zonën e dëmtuar të lëkurës duke patur të veshura doreza sterile.
Gjatë aplikimit, në qoftë se është e nevojshme, mund të përdorni edhe një spatul sterile.
Përpara çdo aplikimi, është e nevojshme të pastroni lëkurën me ujë, solucion fiziologjik ose me një solucion antiseptik.
Kremi Cutadin-S përdoret një ose dy herë në ditë në një shtresë rreth 2 - 3 mm të trashë. Në rastet e rënda kremi mund të përdoret edhe deri 4 herë në ditë.
Trajtimi duhet vazhduar derisa të vihet re një shërim i dukshëm i plagës.

Në qoftë se keni përdorur më shumë Cutadin-S
Në qoftë se keni përdorur më shumë Cutadin - S se sasia që duhet të përdornit, ose në qoftë se fëmijët e kanë përdorur ose marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.
Përdorimi në zona të mëdha ose për një kohë të gjatë i Kremi Cutadin-S, mund të rrisë përqëndrimin sistemik të tij duke shkaktuar kristaluri dhe argiri.

Në qoftë se harroni të përdorni Cutadin-S
Në qoftë se harroni një dozë, përdoreni atë sapo të kujtoheni, përveç rastit kur ka ardhur koha për aplikimin e dozës tjetër.
Mos përdorni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, kremi Cutadin-S mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Kremi Cutadin-S mund të përthithet pas aplikimit lokal dhe të shkaktojë efekte sistemike të ngjashme me ato të sulfonamideve të tjerë.
Njoftoni mjekun tuaj për efektet anësore të mëposhtme që mund t'ju shfaqen:
- reaksione alergjike si: djegie, kruarje, rash;
- dhimbje dhe irritim në vendin e aplikimit;
- leukopeni tranzitore;
- argiri, si pasojë e përthithjes sistemike të argjendit gjatë përdorimit në zona të mëdha të lëkurës dhe për një kohë të gjatë të Cutadin - S.

Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI CUTADIN- S

Mbajeni larg fëmijëve.
Mos e përdorni Cutadin-S pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim.
Ruajeni në temperaturë nën 25°C.
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga dielli dhe nga lagështia.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Cutadin-S – krem

Lënda aktive është sulfadiazinë argjendike.
1 g krem përmban 10 mg sulfadiazinë argjendike.
Përbërës të tjerë: PEG-6 stearat glikol stearat PEG-32 stearat, trigliceride me varg të mesëm, parafinë e bardhë, vaj parafine, metil hidroksibenzoat, propilenglikol, ujë i pastruar.

Përmbajtja e paketimit:
Kuti me 1 tubet 50 g.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuesi:

PROFARMA sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Janar 2024.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible. If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.